

# Si duket korporatizmi dhe pandëshkueshmëria në sistemin prokurorial?







Autorë: Gzim Shala dhe Flamur Kabashi

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës



## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	8
2. Korporatizmi në KPK.....	9
3. Si duket korporatizmi?.....	11
a. Prokurori i Shtetit pa kryeprokurorë.....	11
b. Mungesa e llogaridhënies .....	13
d. Udhëheqja e sistemit prokurorial nga burrat .....	17
e. Konkursset e kundërligjshme .....	19
f. Riciklimi në sistemin prokurorial .....	22
4. Nevoja për reformë .....	24
5. Çfarë synohet të arrijë reforma në KPK? .....	25
6. Dështimet në reformë .....	25



## 1. Përmbledhje ekzekutive

Llogaridhënia, integriteti, sigurimi i pavarësisë së prokurorive dhe transparenca janë shtyllat kryesore për një institucion të sistemit të drejtësisë siç është Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK). Këto parime e bëjnë KPK një institucion funksional dhe të besueshëm. Llogaridhënia siguron që KPK të jetë përgjegjëse dhe transparente për vendimet dhe veprimet e saj, duke ndërtuar në radhë të parë besimin e qytetarëve në sistemin prokurorial por edhe besimin dhe informimin e prokurorëve dhe stafit prokurorial lidhur me mënyrën e operimit dhe administrimit nga KPK si institucion. Integriteti i pakontestueshëm garanton që këto vendime të jenë të paanshme dhe në përputhje me ligjin, procedurën dhe standardet më të larta etike dhe profesionale. Përmbushja e kompetencave sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse siguron funksionimin profesional dhe të pavarur të institucionit, ndërsa transparenca është mekanizmi që i bën të gjitha këto të dukshme dhe të vlerësueshme për publikun. Vetëm përmes këtyre parimeve, KPK mund të tejkalojë perceptimet se ky mekanizëm funksionon në frymën e bazuar në korporatizëm dhe për interesa të një grupi të prokurorëve në sistem dhe të rikthejë legjitimitetin e tij si garantues i drejtësisë dhe shërbimit ndaj interesit publik.

Megjithatë, KPK nuk është duke funksionuar kështu në praktikë. Shkak për këtë është përbërja korporatiste brenda KPK. KPK aktualisht përbëhet nga 13 anëtarë, 10 prej të cilëve prokurorë. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias theksoj se “KPK-ja aktuale përbëhet pothuajse tërësisht nga prokurorë dhe, për këtë arsye, është e prirur ndaj rrezikut të korporatizmit... Siç kanë dëshmuar disa OJQ, pikërisht kështu ka funksionuar KPK-ja në të kaluarën”.

Duke vepruar përmes një mendësie korporatiste, KPK ka shqiptuar sanksione të buta disiplinore ndaj prokurorëve të përfshirë në shkelje disiplinore. Sipas monitorimit të IKD, nga 11 masat disiplinore të shqiptuara nga KPK gjatë vitit 2023 dhe 2024, nëntë (9) prej tyre apo 81.8% e masave disiplinore janë vërejtje publike me shkrim apo vërejtje jo publike me shkrim.

Dështimi për mbrojtjen e jetës, e drejtë kjo themelore sipas Kushtetutës së vendit, për KPK-në rezultoi me zvogëlim të pagës 30% për një vit për prokuroren e rastit, Hava Krasniqi, ndonëse e njëjta sipas vendimit të KPK-së u gjet përgjegjëse pasi nuk kishte vlerësuar rrezikshmërinë dhe nuk kishte marrë veprimet urgjente ligjore. Madje, ky sanksionon disiplinor përfshiu edhe një shkelje tjetër të prokurores. Përmes këtij vendimi, anëtarët e KPK nuk përzgjedhën nevojën e shoqërisë por interesat e kolegëve të tyre. Kjo duke dërguar mesazhin tek të gjithë prokurorët se nëse dështojnë të mbrojnë jetën e një viktime të dhunës në familje, dhe kjo konfirmohet nga Gjykata Kushtetuese, kjo nuk do tu kushtojë të njëjtëve më shumë se ulje e pagës për 30%.

Përgjatë rreth një dekade, KPK u kritikua vazhdimisht për kundërligjshmëri, mungesa të transparencës dhe meritokracisë në proceset për përzgjedhjen e prokurorëve, avancimin e prokurorëve dhe zgjedhjen e kryeprokurorëve. Kjo është fusha tjetër ku KPK shpërfaqti mendësinë e saj korporatiste të veprimit.

Riciklimi i të njëjtave figura në pozita kyçe të sistemit prokurorial të Kosovës ka krijuar një mjedis ku ndryshimi dhe progresi janë bërë pothuajse të pamundura. Kështu, ndryshimi i



përbërjes së KPK duket se nuk nënkupton ndryshim të mendësisë korporatiste. Për këtë arsye, zgjidhja e vetme për shmangie të kësaj mendësie duket të jetë reforma në KPK, e cila për herë të dytë është duke pritur një vendim të Gjykatës Kushtetuese.

## 2. Korporatizmi në KPK

Një sistem prokurorial që nuk i shërben ekskluzivisht interesit të publikut rrezikon të humbasë besimin e qytetarëve dhe legjitimitetin e tij. Për këtë arsye, është thelbësore që KPK të veprojë me transparencë të plotë dhe të jetë i hapur për llogaridhënie para publikut. KPK duhet të përmbushë me përgjegjësi mandatin e saj kushtetues për të siguruar pavarësinë, profesionalizmin dhe integritetin e sistemit prokurorial. Llogaridhënia ndaj publikut dhe përfshirja e tij si një palë e interesuar ndihmon në rritjen e besimit në institucione, minimizimin e kulturës së pandëshkueshmërisë dhe krijimin e një mendësie që e shikon transparencën si një vlerë të domosdoshme. Vetëm përmes një qasjeje të tillë, KPK mund të tejkalojë perceptimet për korporatizëm dhe t'i rikthejë sistemit prokurorial funksionin e tij si garantues i drejtësisë dhe mbrojtës i interesit publik.

Për vite me radhë, KPK nuk ka vepruar kështu, duke mos ju përgjigjur plotësisht shoqërisë sipas rolit që ka. Sistemi prokurorial i Kosovës ka dështuar në gjenerimin e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, derisa në shumë raste është përfshirë në dyshime për shkelje të cilave nuk i ka dhënë përgjigje. Kjo situatë nuk i takon vetëm periudhës së fundit. Në këtë situatë, sistemi prokurorial gjendet pothuajse tash e një dekadë.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore”<sup>1</sup>. Kushtetuta dhe Ligji ia japin KPK-së kompetencat e nevojshme për të materializuar këto synime.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligj ky tanimë i shfuqizuar, i cili ishte miratuar në vitin 2010, KPK përbëhej nga nëntë (9) anëtarë, pesë (5) prej të cilëve prokurorë<sup>2</sup>. Kjo përbërje zgjati deri më 1 janar 2016, kur numri i anëtarëve të KPK u rrit në 13. Kjo rritje u bë në favor të prokurorëve. Sipas këtij Ligji, KPK do të përbëhej nga 13 anëtarë, 10 prej të cilëve nga radhët e sistemit prokurorial (7) nga Prokuroritë Themelore, nga 1 nga PSRK dhe Prokuroria e Apelit dhe Kryeprokurori i Shtetit dhe tre (3) anëtarë të jashtëm: Një (1) anëtarë nga Oda e Avokatëve të Kosovës, një (1) profesor nga fakultetet juridike dhe një (1) përfaqësues i shoqërisë civile.

Ligji NR. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili aktualisht është në fuqi, e ka ruajtur këtë përbërje. Kjo përbërje, pa marrë parasysh personat që kanë qenë anëtarë të KPK, ka vepruar përmes një mendësie korporatiste. Kjo në atë mënyrë që kjo përbërje më shumë angazhimit për të siguruar pavarësi, profesionalizëm dhe llogaridhënie, ka krijuar një mendësi

---

<sup>1</sup> Kushtetuta, neni 110.1.

<sup>2</sup> Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 5.

korporatiste deri në ndërtimin e tanimë një kulture të pandëshkueshmërisë. Disa nga rastet e paraqitura në këtë dokument do ta dëshmojnë këtë.

Në kuadër të përpjekjeve të Qeverisë për ta ndryshuar këtë përbërje të KPK, e cila nuk solli rezultatet e nevojshme, Komisioni i Venecias analizoj këtë përbërje. Sipas këtij Komisioni, kjo përbërje e KPK është një përbërje korporatiste.

Fillimisht, në lidhje me përbërjen aktuale të KPK, opinioni i Komisionit të Venecias theksoj se ky Komision ka mbrojtur vazhdimisht këshillat prokurorialë ku prokurorët e zgjedhur nga kolegët e tyre përfaqësojnë një “pjesë të rëndësishme”, por jo domosdoshmërisht shumicën e anëtarëve<sup>3</sup>.

Në raport me përbërjen aktuale të KPK, Komisioni i Venecias nënvizoi se: “KPK-ja aktuale përbëhet pothuajse tërësisht nga prokurorë dhe, për këtë arsye, është e prirur ndaj rrezikut të korporatizmit. Për më tepër, në Kosovë, shumica e anëtarëve prokurorialë të KPK-së vijnë nga zyrat prokuroriale të niveleve të ulëta. Është krejtësisht e natyrshme që, edhe në mungesë të një lidhje formale subordinimi, ata mund të perceptohen se votojnë së bashku me kolegët e tyre të nivelit më të lartë, dhe në veçanti me Kryeprokurorin e Shtetit. Siç kanë dëshmuar disa OJQ, pikërisht kështu ka funksionuar KPK-ja në të kaluarën”. Për këtë arsye, Komisioni i Venecias theksoj se reduktimi i përqindjes së anëtarëve prokurorialë mund të ndihmojë në luftimin e tendencës korporatiste të këtij organi, ose perceptimit të një tendence të tillë. Megjithatë, ky reformim nuk duhet të qojë në nënshtrimin e KPK ndaj shumicës qeveritare të Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>4</sup>.

Çështja e përbërjes korporatiste të KPK, ndonëse nuk u emërtua si e tillë në rastin konkret, ishte trajtuar edhe gjatë procesit të Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Një prej dokumenteve të dala nga ky proces theksonte se “proporcioni i prokurorëve është më i lartë në KPK se sa ai i gjyqtarëve në KGJK. Duke e pasur parasysh mënyrën se si merren vendimet në Këshill, mund të jetë shqetësuese mbizotërimi dërmues i prokurorëve dhe kompetenca shumë e kufizuar e kontributit nga anëtarët e jashtëm, si pjesë e një sistemi kuptimplotë dhe të praktikueshëm të kontrolleve dhe balancave. Ndryshimet e bëra në vitin 2015 në përbërjen e KPK-së, duke e rritur numrin e anëtarëve të prokurorisë nga 5 në 10, është kritikuar nga ekspertët, të cilët kanë theksuar që shumica e thjeshtë e prokurorëve në Këshill është shndërruar në shumicë dërmuese.

Më tej, dokumenti i dalë nga procesi i Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit thekson që në praktikë situata është më shqetësuese pasi që Kuvendi nuk ka arritur t'i zgjedhë tre anëtarët jo-prokurorë të Këshillit dhe rezultati tani është që organi i cili është supozuar të jetë përgjegjës për parashikimin e pavarur të shërbimit të prokurorisë të përbërë tërësisht nga prokurorët që i japin llogari vetëm prokurorëve të tyre kolegë, duke e pamundësuar një

---

<sup>3</sup>IKD dhe FOL: Komisioni i Venecias s'i përkrahu ndryshimet e MD-së për rritjen e përkohshme të anëtarëve të KPK-së në 19 deri në janar të vitit 2026 (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-komisioni-i-venecias-si-perkrahu-ndryshimet-e-md-se-per-rritjen-e-perkohshme-te-anetareve-te-kpk-se-ne-19-deri-ne-janar-te-vitit-2026/>)

<sup>4</sup> Po aty, par.27

mbikëqyrje të pavarur. Është konkluduar që autoritetet duhet të kenë parasysh zvogëlimin e numrit të 10 anëtarëve aktualë prokurorë të KPK-së”<sup>5</sup>.

Kështu, është plotësisht e qartë, se përbërja e KPK paraqet një përbërje korporatiste. Madje, Komisioni i Venecias nënvizoi se “Siç kanë dëshmuar disa OJQ, pikërisht kështu ka funksionuar KPK-ja në të kaluarën...<sup>6</sup>”.

Kjo përbërje korporatiste, pa marrë parasysh anëtarët që ka pasur, tash e gati një dekadë, ka vepruar përmes një mendësie korporatiste, duke mos arritur objektivat që ka KPK sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Veprimi i tillë, fatkeqësisht, tanimë ka ndërtuar një kulturë të pandëshkueshmërisë brenda sistemit prokurorial, ku mendësia korporatiste nuk lejon sistemin prokurorial që tërësisht ti shërbejë publikut dhe të perceptohet si i tillë.

Por, si duket “korporatizmi” brenda sistemit prokurorial dhe cilat janë efektet e veprimit korporatist. Çfarë është kultura e pandëshkueshmërisë të cilën e ka sjellë veprimi korporatist. Në vijim të këtij dokumenti do të paraqesim disa prej situatave ku manifestohet veprimi korporatist brenda sistemit prokurorial, duke qenë të vetëdijshëm se një listë e tillë nuk është shteruese.

### 3. Si duket korporatizmi?

#### a. Prokurori i Shtetit pa kryeprokurorë

Konkursi i shpallur për Kryeprokuror të ri të shtetit me 12 janar 2022 e i përfunduar me 6 prill 2022<sup>7</sup> ishte shoqëruar me parregullsi të shumta. Ky proces kishte ngjallur reagime të shumta në Kosovë me çka kishin reaguar Shoqëria Civile<sup>8</sup> dhe Ambasadat kryesore në vend.<sup>9</sup> Sipas

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> *Raporti i Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit*, par.27. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2023\)043-e&fbclid=IwAR0aZaNUs-9B5s39E6uN-iXzaSnelj3KpLX9LzWBe7tMO5BDIHuyOEm\\_-oM](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2023)043-e&fbclid=IwAR0aZaNUs-9B5s39E6uN-iXzaSnelj3KpLX9LzWBe7tMO5BDIHuyOEm_-oM))

<sup>7</sup> “KPK voton Blerim Isufajin për Kryeprokuror të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 6 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohen-kundershtimet-e-kandidateve-per-kryeprokuror-te-shtetit-kpk-popergatitet-per-votimin-e-blerim-isufajit-per-kryeprokuror-te-ri-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 26 prill 2024).

<sup>8</sup> (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/koalicioni-i-ojq-ve-rekomandon-te-anulohet-procesi-i-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit-dhe-te-shpallet-konkurs-i-ri/>), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

<sup>9</sup> **Shënim:** Ndaj këtij procesi kanë reaguar Ambasada Britanike, Ambasada Gjermane, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Ambasada Amerikane, duke u shprehur të zhgënjyer me këtë proces.

“Edhe Gjermania e zhgënjyer me procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun: [https://betimiperdrejtesi.com/edhe-gjermania-e-zhgenjyer-me-procesin-e-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/?fbclid=IwAR0\\_L4D\\_-](https://betimiperdrejtesi.com/edhe-gjermania-e-zhgenjyer-me-procesin-e-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/?fbclid=IwAR0_L4D_-) (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

[4VtMuA4I6MiYZPXpbd2TCOutkbTOË8YNarGj7fkZV2pëbD8vnU](https://betimiperdrejtesi.com/edhe-gjermania-e-zhgenjyer-me-procesin-e-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit/?fbclid=IwAR0_L4D_-)). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)). “Szunyog i reagon KPK-së pas votimit të Blerim Isufajit për Kryeprokuror të Shtetit: Jemi të habitur dhe të zhgënjyer”. Betimi për Drejtësi. 6 prill 2022. (Shih linkun: [https://betimiperdrejtesi.com/szunyog-i-reagon-kpk-sepas-votimit-te-blerim-isufajit-per-kryeprokuror-te-shtetit-jemi-te-habitu-dhe-tezhgenjyer/?fbclid=IwAR18t\\_fFSKo0qËVL0yCc-urUVsHmIJIJ9MGLYnucvP2xSKHifa6a7sm6FK0](https://betimiperdrejtesi.com/szunyog-i-reagon-kpk-sepas-votimit-te-blerim-isufajit-per-kryeprokuror-te-shtetit-jemi-te-habitu-dhe-tezhgenjyer/?fbclid=IwAR18t_fFSKo0qËVL0yCc-urUVsHmIJIJ9MGLYnucvP2xSKHifa6a7sm6FK0)), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

“Ambasadori amerikan i shqetësuar për mënyrën se si u votua për Kryeprokurorin e Shtetit, thotë se nuk u respektuan standardet”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun:

Koalicioni të OJQ-ve që kishin monitoruar këtë proces, procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka siguruar meritokraci, objektivitet dhe se kandidatët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, çka sipas koalicionit ky proces ishte shoqëruar me shkelje të shumta të procedurave<sup>10</sup>.

Megjithatë, edhe përkundër kritikave për këtë proces, KPK kishte vazhduar me këtë proces, duke dërguar rekomandimin për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit tek Presidentja e Republikës së Kosovës. Por se ky propozim i KPK-së ishte refuzuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, e cila zgjodhi të rreshtohet me kritikën e OJQ-ve dhe ndërkombëtarëve duke e kthyer mbrapsht procesin për Kryeprokuror të Shtetit.<sup>11</sup> Duke mos dëshmuar kulturë të bashkëpunimit dhe komunikimit ndër institucional, ku vendimet e institucioneve të tjera ose atakohen në instancat gjyqësore ose zbatohen, KPK thjesht nuk u pajtua me këtë vendim, duke e cilësuar këtë veprim si përpjekje për shtrirje të ndikimit politik mbi sistemin prokurorial<sup>12</sup>, përkundër se KPK nuk dha asnjëherë përgjigje në raport me gjetjet që dëshmonin mungesë të transparencës, barabarësisë dhe meritokracisë së procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Pas vendimi të Presidentes Osmani për refuzimin e dekretimit të kandidatit të rekomanduar nga KPK për Kryeprokuror të Shtetit, KPK me 25 tetor 2023 i ishte drejtuar sërish presidentes duke propozuar emrin e njëjtë për kryeprokuror.<sup>13</sup> Emri në këtë rast nuk dilte nga një proces i ri i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, por vetëm një ridërgim i emrit të njëjtë.

Letra e KPK-së e nënshkruar nga ish-kryesuesi i KPK-së, duke iu drejtuar për herë të dytë presidentes me emrin e njëjtë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi. KPK në rastin konkret do të duhej që, duke adresuar gjetjet e Presidentes së Republikës së Kosovës, të organizonte një proces të ri konkurrimi duke garantuar meritokraci të procesit dhe më pastaj të rekomandonte kandidatin e përzgjedhur për Kryeprokuror të Shtetit. Megjithatë, KPK nuk veproj kështu, duke dëshmuar mungesë të thellë të vullnetit për të adresuar gjitha problemet e evidentuara nga shoqëria civile, partnerët ndërkombëtarë dhe Presidentja e Republikës së Kosovës.

---

<https://betimiperdrejtesi.com/ambasadoriamerikan-i-shqetesuar-per-menyren-se-si-u-votua-per-kryeprokurorin-e-shtetit-thote-se-nuk-u-respektuanstandartet/?fbclid=IëAR2ZFs4-44Tmbk498zmmvs-0lEfhë49AdRyt9l2QSyFNSVI4JLëZF2Pyah0> ). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024)

<sup>10</sup>Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, IKD, GLPS, Lëvizja Fol, mars 2022, (Shih linkun: [https://kli-ks.org/ëp-content/uploads/2022/03/IKD-GLPS-FOL\\_Raporti-Final\\_Procesi-per-Kryeprokuror-te-Shtetit-1.pdf](https://kli-ks.org/ëp-content/uploads/2022/03/IKD-GLPS-FOL_Raporti-Final_Procesi-per-Kryeprokuror-te-Shtetit-1.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>11</sup>“Presidentja rreshtohet me kritikën e OJQ-ve dhe ndërkombëtarëve, kthen mbrapsht procesin për Kryeprokuror të Shtetit” Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/presidentja-rreshtohet-me-kritikat-e-ojq-ve-dhe-nderkombetareve-kthen-mbrapsht-procesin-per-kryeprokuror-te-shtetit/> ), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>12</sup>“KPK për mosdekretimin e Isufajt si kryeprokuror: Presidentja vërtetoi përpjekjen për shtrirje të ndikimit politik mbi sistemin prokurorial”. Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-per-mosdekretimin-e-isufajt-si-kryeprokuror-presidentja-vertetoi-perpjekjen-per-shtrirje-te-ndikimit-politik-mbi-sistemin-prokurorial/> ), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>13</sup>“Ekskluzive: Çka përmban letra me të cilën KPK-ja ia dorëzoi Presidentes sërish emrin e Isufajt për Kryeprokuror të Shtetit?”. Betimi për Drejtësi. 1 nëntor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-cka-permban-letra-me-te-cilen-kpk-ja-ia-dorezoi-presidences-serish-emrin-e-isufajt-per-kryeprokuror-te-shtetit/> ). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

Me 4 mars 2024, organizatat jo qeveritare i kërkuan KPK të shpallë sa më parë konkursin për Kryeprokuror të Shtetit. Sipas këtij reagimi “Nëse deri më 17 tetor 2023 KPK nuk ka pasur përgjegjësi për vonesat që janë krijuar në këtë proces për shkak se propozimi ishte tek Presidentja e Republikës së Kosovës, që nga kjo datë e tutje, KPK është institucioni i vetëm përgjegjës pse Kosova nuk ka Kryeprokuror të Shtetit”<sup>14</sup>. Raporti i Komisionit Evropian për Vendin theksoj se “KPK-ja duhet të përsërisë shpejt procesin për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, duke respektuar parimet e transparencës dhe meritokracisë”<sup>15</sup>.

Megjithatë, KPK nuk vepron asnjëherë në këtë drejtim. Përballë nevojës që vendi të ketë Kryeprokurorë të Shtetit, KPK nuk i është përgjigjur kësaj nevojë shoqërore, por heshturazi ka vendosur mos ta hapë konkursin e ri për Kryeprokurorë të Shtetit, duke insistuar, në mënyrë kundër kushtetuese dhe kundër ligjore, në kandidatin e njëjtë, i cili kishte dalë nga një proces që nga shoqëria civile, partnerët ndërkombëtar dhe Presidentja u cilësua si i parregullt.

Kështu, në tërësi këtë situatë, është e qartë se përbërja korporatiste e KPK, veprimi me mendësi korporatiste në këtë rast. Kjo mendësi dhe kjo mënyrë e veprimit e ka lënë sistemit prokurorial pa Kryeprokuror të Shtetit tash e disa vite.

Gjithashtu, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023<sup>16</sup> për vitin 2024<sup>17</sup> kanë kërkuar që të shpallet konkursi për Kryeprokurorin të Shtetit, duke theksuar se procesi të zhvillohet duke respektuar parimet e transparencës dhe meritokracisë.

#### b. Mungesa e llogaridhënies

Të gjitha rastet disiplinore ndaj prokurorëve gjatë vitit 2023 kishin përfunduar me shqiptimin e sanksioneve të buta disiplinore si vërejtje publike dhe jo publike me shkrim. Nga pesë (5) vendimet disiplinore, masa më e rëndë e shqiptuar nga KPK ishte ulje e pagës 30% për një vit, derisa në katër raste të tjera shqiptojë vërejtje, dy (2) nga të cilat jo publike.

Kërkesa	Panele hetimore	Raste të inicuar	Masa disiplinore	Vërejtje publike me shkrim	Vërejtje jo publike	Ulje e pagës 30%
8	7	8	5	2	2	1

Tabela 1. Shyqrtimi i rasteve disiplinore nga KPK gjatë vitit 2023.

<sup>14</sup> IKD, FOL dhe INPO: KPK të shpallë sa më parë konkursin e ri për Kryeprokuror të Shtetit, IKD, 4 mars 2024, (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-fol-dhe-inpo-kpk-te-shpalle-sa-me-pare-konkursin-e-ri-per-kryeprokuror-te-shtetit/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

<sup>15</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2024, f.26, (Shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-ja8a943c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-ja8a943c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

<sup>16</sup> [file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Kosovo%202023%20Report\\_SQ%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Kosovo%202023%20Report_SQ%20(2).pdf), fq.17

<sup>17</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2024, f.26, (Shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-ja8a943c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-ja8a943c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

Gjatë vitin 2024, masa më e rëndë e shqiptuar ka qenë ulje e pagës 30% për tre (3) muaj. Ndërsa, të gjitha masat e tjera, gjithsej pesë (5) të shqiptuara nga KPK gjatë vitit 2024 janë vërejtje publike me shkrim.

Raste të bartura nga viti paraprak	Kërkesa	Panele Hetimore	Raste të Inicjuara	Masa Disiplinore	Vërejtje publike me shkrim	Vërejtje jo publike	Ulje e pagës 30%	Në procedurë/veprime të tjera
4	6	6	6	6	5	0	1	3

**Tabela 2: Shqyrtimi i rasteve disiplinore nga KPK gjatë vitit 2024.**

Kështu, në drejtim të disiplinimit të prokurorëve, KPK ka ndjekur një politikë të butë sa i përket shqiptimit të këtyre sanksioneve. Përkatësisht, nga 11 masat disiplinore të shqiptuara nga KPK gjatë vitit 2023 dhe 2024, nëntë (9) prej tyre apo 81.8% e masave disiplinore janë vërejtje publike me shkrim apo vërejtje jo publike me shkrim. Është e qartë se kjo lloj politike e shqiptimit të dënimeve nuk garanton efektivitetet të procedurave disiplinore, përderisa në parim shqiptohet këto sanksione të buta disiplinore.

Që nga miratimi i tij, IKD ka monitoruar zbatimin në praktikë të Ligjit NR. 06/L-057 për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Njëri prej raporteve të IKD mbi zbatimin në praktikë të këtij Ligji theksonte se “Tejkalimi i diskrecionit të vlerësimit të autoriteteve kompetente është shumë i shprehur në sistemin prokurorial. Mungesa e mbikëqyrjes së KPK-së ndaj autoriteteve kompetente dhe mos përfshirja e IAP-së ashtu siç përcaktohet me ligj në sistemin e llogaridhënies së prokurorëve ka krijuar mungesë të llogaridhënies tek vet KPK. Në jo pak raste, vet autoritetet kompetente kanë kryer shkelje disiplinore, por se janë amnistuar nga KPK. Disa nga vendimet e autoriteteve kompetente janë përfshirë në gabime të qarta profesionale, derisa IKD ka gjetur edhe qasje selektive të prokurorëve nga ana e autoriteteve kompetente”<sup>18</sup>.

Përballë kësaj situatë, përderisa KGJK nxori vendim për publikimin e vendimeve të autoriteteve kompetente për hedhjen e ankesave disiplinore<sup>19</sup>, KPK nuk e bëri këtë. Siç do të shihet në vijim, pati rasti kur KPK krijoi përshtypje të tendencës së fshehjes së këtyre rasteve, duke mos publikuar vendimet disiplinore.


Në praktikë shohim se ka shumë raste kur shumë prej aktakuzave të korrupsionit dështojnë në gjykata e shumë prej tyre nuk arrijnë as të konfirmohen. Ka prokuror që ngrisin aktakuza për korrupsion ndaj personave që nuk e kanë fare cilësinë e personave zyrtar, ka të tjerë që për një person të caktuar ngrisin me dhjetëra aktakuza e nuk i bashkojnë ato por këtë e bëjnë për t’a

<sup>18</sup> IKD, *Llogaridhënia pa progres – Analizë e moszbatimit të ligjit për përgjegjësin disiplinore e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve*, fq.5 (Shih linkun: [https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2021/11/IKD\\_Llogaridhenia-2021\\_Final.pdf](https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2021/11/IKD_Llogaridhenia-2021_Final.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

<sup>19</sup> Vendimi i KGJK

plotësuar normën e punës, ka kritika të vazhdueshme për cilësinë e aktakuzave<sup>20</sup> etj. Po ashtu, edhe raportet ndërkombëtare theksojnë mungesë të kompetencës së prokurorëve<sup>21</sup>.

Gjatë vitit 2023, asnjë prej prokurorëve nuk ka marrë vlerësimin e pamjaftueshëm, nga 52 vlerësime të performancës së prokurorëve të niveleve të ndryshme. Nga këto vlerësime 33 prokurorë janë vlerësuar me vlerësimet “shumë mirë”, (18) prokuror “mjaftueshëm” dhe një “dalluar”.



Grafiku 1. Vlerësimet e 52 prokurorëve në nivele të ndryshme.

Në këtë situatë, përballë problemeve të shumta të cilat evidentohen vazhdimisht në praktikë, të njëjtat probleme nuk adresohen nga KPK. Përballë nevojës së shoqërisë për veprim të KPK drejt mbajtjes llogaridhënës të prokurorëve, KPK duket se në kuptim të mendësisë korporatiste, më primare e ka mbrojtjen e kolegëve të saj, se sa rritjen e llogaridhënies brenda sistemit prokurorial.

Lidhur me cilësinë e dobët të aktakuzave edhe Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2024<sup>22</sup> ka theksuar se cilësia e aktakuzat dhe aktgjykimet në raport me ligjin penal janë të pamjaftueshme.

### c. 30% ulje e pagës për shkelje të së drejtën në jetë

Gjykata Kushtetuese, me aktgjykimin e 12 marsit 2023, kishte konstatuar se Sebahate Morinës, i'u mohua e drejta për jetë.<sup>23</sup> E ndjera, u vra nga ish-bashkëshorti më 14 mars 2021 në Prishtinë,

<sup>20</sup> Makshana L “Ndjekja dhe Gjykimi i Korrupsionit 2023”. Prishtinë. Dhjetor 2023.

<sup>21</sup> Shih Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2023, faqe 20.(shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3\\_en?filename=SËD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SËD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>22</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën; fq. 17; Bruksel, 30 tetor 2024; (Shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf))

<sup>23</sup> “Vlerësimi i kushtetutshmërisë së “veprimeve dhe mosveprimeve”, të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë”,

si pasojë e neglizhimit të rastit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe Stacioni Policor në Graçanicë.

Tri ditë pas rastit, IKD kishte publikuar raportin “*Shteti me mosveprim privon nga jeta Sebahate Morinën*”, ku ishin prezantuar shkeljet e institucioneve shtetërore dhe dështimi për të mbrojtur jetën viktimës.<sup>24</sup> Ky rast ishte përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese nga Qendra për Ndihmë Juridike e IKD<sup>25</sup>. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që konfirmonte gjetjet e IKD u cilësua si historik nga Komisioni Evropian.<sup>26</sup> Ky vendim është përmendur edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën për vitin 2023.<sup>27</sup>

Përballë kërkesës për llogaridhënie<sup>28</sup>, Prokuroria Themelore në Prishtinë zgjodhi sulmin ndaj shoqërisë civile<sup>29</sup>. Që nga data e vrasjes së Sebahate Morinës e deri në nxjerrjen e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, sistemi prokurorial vazhdimisht mohoi përgjegjësinë për këtë rast, duke mos u iniciuar asnjë procedurë disiplinore. Madje, duke u akuzuar IKD për qasje tendencioze në raport me sistemin prokurorial.

Vetëm pas nxjerrjen së aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese, u iniciua procedurë disiplinore ndaj prokurores së këtij rasti.<sup>30</sup>

Dështimi për mbrojtjen e jetës, e drejtë kjo themelore sipas Kushtetutës së vendit, për KPK-në rezultoi me zvogëlim të pagës 30% për një vit për prokuroren e rastit, Hava Krasniqi, ndonëse e njëjta sipas vendimit të KPK-së u gjet përgjegjëse pasi nuk kishte vlerësuar rrezikshmërinë dhe nuk kishte marrë veprimet urgjente ligjore.

KPK kishte tentuar që ta mbajë larg publikut këtë vendim për më shumë se shtatë (7) muaj duke mos e publikuar në ueb-faqen e KPK-së deri në janar të vitit 2024, edhe pse vendimi ishte

---

Gjykata Kushtetuese, 22 mars 2023. [https://gjk-ks.org/decision/leresim-i-kushtetutshmerise-se-veprimeve-dhe-mosveprimeve-te-gjykates-themelore-ne-gjilan-prokurorise-themelore-ne-gjilan-stacionit-policor-ne-gracanice-dhe-prokurorise-themelore-n/?decision\\_vieë=text](https://gjk-ks.org/decision/leresim-i-kushtetutshmerise-se-veprimeve-dhe-mosveprimeve-te-gjykates-themelore-ne-gjilan-prokurorise-themelore-ne-gjilan-stacionit-policor-ne-gracanice-dhe-prokurorise-themelore-n/?decision_vieë=text) (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>24</sup> Shteti me mosveprim privon nga jeta Sebahate Morinën”, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 17 mars 2021. <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2021/03/IKD-Shteti-me-mos-veprim-privon-nga-jeta-Sebahate-Morinën-17.03.2021-1.pdf> (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>25</sup> Dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kërkesa përmes së cilës propozohet të konstatohet shkelja e të drejtës për jetën, në rastin e Sebahate Morinës (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dorezohet-ne-gjykatën-kushtetuese-te-kosoves-kerkesa-permes-se-ciles-propozohet-te-konstatohet-shkelja-e-te-drejtës-per-jeten-ne-rastin-e-sebahate-morines/>)

<sup>26</sup> “Raporti i Progresit rithekson dështimin e institucioneve në rastin e Sebahate Morinës”. Betimi për Drejtësi. 8 nëntor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/raporti-i-progresit-rithekson-deshtimin-e-institucioneve-ne-rastin-e-sebahate-morines/>). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>27</sup> “2023 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo”. ( Shih linkun: <https://ë.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/> ). (Qasur për herë të fundit më 24 prill 2024).

<sup>28</sup> “Shala pas vendimit të Kushtetueses: Të dorëhiqet Kryeprokurori Munishi dhe prokurori i rastit të Sebahate Morinës”, Betimi për Drejtësi, 23 mars 2023. <https://betimiperdrejtesi.com/shala-pas-vendimit-te-kushtetueses-te-dorehiqet-kryeprokurori-munishi-dhe-prokurori-i-rastit-te-sebahate-morines/> (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>29</sup> <https://prokuroria-rks.org/pthprishtine/lajm/reagim-nga-prokuroria-themelore-ne-prishtine-6/>

<sup>30</sup> “Njoftim për media nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit”, Prokurori i shtetit, 5 prill 2023. <https://prokuroria-rks.org/al/psh/lajm/9693> (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).



marrë me 26 qershor 2023.<sup>31</sup> Arsyetimi i KPK për këtë ishte se ky vendim ishte hequr rastësisht nga ueb-portali<sup>32</sup>.

Edhe më shqetësues është fakti se sanksioni disiplinor me ulje të pagës, nuk ishte sanksion vetëm për një shkelje disiplinore të prokurores Krasniqi të cilës i'u shqiptua kjo masë disiplinore. Kjo pasi KPK këtë masë e shqiptoi edhe për një rast tjetër të shkeljes disiplinore nga prokurorja Krasniqi. Thënë më ndryshe, sanksioni prej 30% të uljes së pagës ishte edhe për një shkelje tjetër disiplinore, pos asaj shkelje që kishte rezultuar me shkelje të së drejtës në jetë.

Ky është rasti tipik që tregon se si vepron një kulturë dhe mendësi korporatiste brenda sistemit prokurorial të Kosovës, ku tanimë është ndërtuar kultura e pandëshkueshmërisë<sup>33</sup>. Në rastin e Sebahate Morinës, bëhet fjalë për vrasjen e një gruaje si rezultat i neglizhimit të rastit nga Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës. Përballë të gjitha fakteve të konstatuar, sistemi prokurorial nuk inicioj asnjëherë asnjë procedurë disiplinore ndaj askujt. Vetëm pas aktgjyqimit të gjykatës kushtetuese, KPK i shqiptoi prokurores së rastit një sanksion me ulje të pagës 30% për një vit. Në fakt, ky sanksion u shqiptua edhe për një shkelje tjetër, pos asaj që kishte të bënte me shkeljen e së drejtës në jetë.

Përballë nevojës për të dërguar mesazh tek shoqëria dhe, veçanërisht, viktimat e dhunës në familje, për përgjigje institucionale në këtë raste, KPK vlerësoi me mendësi korporatiste. Anëtarët e KPK nuk për zgjedhën nevojën e shoqërisë por interesat e kolegëve të tyre. Kjo duke dërguar mesazhin tek të gjithë prokurorët se nëse dështojnë të mbrojnë jetën e një viktime të dhunës në familje, dhe kjo konfirmohet nga Gjykata Kushtetuese, kjo nuk do tu kushtojë të njëjtëve më shumë se ulje e pagës për 30%.

#### d. Udhëheqja e sistemit prokurorial nga burrat

Barazia gjinore është vlerë kushtetuese<sup>34</sup>. Pos Kushtetutës, Kosova ka miratuar edhe Ligje të shumta të cilat kërkojnë respektimin e barazisë gjinore.<sup>35</sup> Po ashtu, Ligji **06/L-056** për Këshillin

---

<sup>31</sup> “Kushtetuesja konstatoi se i ishte shkelur e drejta për jetë Sebahate Morinës, KPK mjaftohet me 30% ulje të pagës për prokuroren Hava Krasniqi”, Betimi për Drejtësi, 30 janar 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/kushtetuesja-konstatoi-se-i-ishte-shkelur-e-drejta-per-jete-sebahate-morines-kpk-mjaftohet-me-30-ulje-te-pages-per-prokuroren-hava-krasniqi/> (Qasur për here të fundit më 11 dhjetor 2024).

<sup>32</sup> “Kushtetuesja konstatoi se i ishte shkelur e drejta për jetë Sebahate Morinës, KPK mjaftohet me 30% ulje të pagës për prokuroren Hava Krasniqi”; Betimi për Drejtësi, 30 janar 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kushtetuesja-konstatoi-se-i-ishte-shkelur-e-drejta-per-jete-sebahate-morines-kpk-mjaftohet-me-30-ulje-te-pages-per-prokuroren-hava-krasniqi/>).


<sup>33</sup> “IKD dhe familja Morina: KPK amnistoi prokuroren, neglizhenca e të cilës vrau Sebahate Morinën”, Betimi për Drejtësi, 31 janar 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-dhe-familja-morina-kpk-amnistoi-prokuroren-neglizhenca-e-te-ciles-vrau-sebahate-morinen/>

<sup>34</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 71 (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>)

<sup>35</sup> **Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi gjinore, neni 6.8:** “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.

Prokurorial ka përcaktuar se KPK do të mbikëqyr kriteret për pranim në prokurori, kritere këto ku përfshihet edhe barazia gjinore<sup>36</sup>.

Mungesa e barazisë gjinore është pak e shprehur në numrin e prokurorëve të Prokurorit të Shtetit, shumë e shprehur në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe absolute në pozitën udhëheqëse brenda sistemit prokurorial të Kosovës. Deri në fund të vitit 2023 kanë qenë 189 prokurorë në sistemin prokurorial. Nga 189 prokurorë, 41% e tyre janë gra:



Grafiku 2. Përqindja e prokurorëve gra deri në fund të vitit 2023.

Por, asnjë prokurori në vend nuk udhëhiqet nga ndonjë grua. Nga dhjetë (10) zyrat e prokurorive, të gjitha udhëhiqen nga burrat. E njëjta vlen edhe për Këshillin Prokurorial, i cili udhëhiqet nga një burrë.

(Pa) barazia gjinore është e theksuar edhe në përbërjen e KPK-së. Nga 10 anëtarë sa ka pasur KPK deri në fund të vitit 2023, vetëm tri (3) prej tyre kanë qenë gra. Shprehur në përqindje, në kuptim të numrit të anëtarëve prokurorë, i bie se 70% e KPK-së është përbërë nga anëtarët burra dhe vetëm 30% nga anëtarët gra. Fatkeqësisht, ky numër ka ndryshuar në vitin 2024, kjo pasi anëtares nga radhët e PSRK i kishte skaduar mandati.

Pas shpalljes së konkursit për pozitën e anëtarit të KPK-së nga radhët e prokurorëve të PSRK-së, garës i janë nënshtruar prokurori Milot Krasniqi dhe prokurorja Habibe Salihu. [Në zgjedhjet e mbajtura më 15 mars 2024](#), prokurori Krasniqi ka arritur të marrë 10 vota, ndërsa prokurorja Salihu tri vota.

Rregullorja për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë, Rregullore kjo e miratuar pikërisht nga KPK, thekson [neni 5.2.] se Këshilli duhet të kujdeset dhe të bëjë vlerësimet paraprake mbi nivelin e përfaqësimit gjinor. Tutje, paragrafi 3 i po këtij neni ka paraparë se: “ *Nëse ka aplikues nga komunitetet joshumicë ose të gjinisë femërore, KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë dhe **së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore***”. Sipas rregullores përkatëse, kërkohet që në përbërjen e KPK-së minimumi të jenë tri (3) anëtare të gjinisë femërore. Duke u bazuar në rregulloren e miratuar nga vet KPK, organizatat e shoqërisë civile i kërkuan KPK që të sigurojë barazinë gjinore.

<sup>36</sup> LIGJI NR. 06/L-056 PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS, neni 6.1.1.4.

Përkundër obligimit që pati, obligim të cilin KPK ia kishte caktuar vetes së vet, ajo vendosi që si kandidatë të përzgjedhur ta konstatojë një burrë dhe jo një grua, duke shkelur kuotën gjinore sipas Rregullores për zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë<sup>37</sup>.

Përtej cenimit të barazisë gjinore, kjo qasje dëshmon se KPK pothuajse vetëm formalisht miraton akte nënligjore të cilat synojnë avancimin në fusha të caktuara. Kjo pasi në raste të caktuara, mendësia korporatiste e saj e KPK tejkalon këto rregullore të cilat shkelen pa asnjë vështirësi nga KPK.

#### e. Konkursi e kundërligjshme

Përgjatë rreth një dekade, KPK u kritikua vazhdimisht për kundërligjshmëri, mungesa të transparencës dhe meritokracisë në proceset për përzgjedhjen e prokurorëve, avancimin e prokurorëve dhe zgjedhjen e kryeprokurorëve. Kjo është fusha tjetër ku KPK shpërfaq mendësinë e saj korporatiste të veprimit.

Me 6 qershor 2014, KPK propozoi Aleksandër Lumezin për Kryeprokuror të Shtetit. Lumezi morri votat e katër nga shtatë anëtarët e KPK. Vendimi për emërimin e Lumezit në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit doli të jetë kundërkushtetues, për të cilën u anulua nga Gjykata Kushtetuese. Pas kësaj, si kandidat i vetëm, nëpërmjet një procesi të kontestuar, KPK propozoi përsëri Lumezin si kandidat për Kryeprokuror të Shtetit, i cili më pas u dekretua nga ish-presidentja<sup>38</sup>.

KPK edhe përgjatë vitit 2016 kishte vijuar me vendime të kundërligjshme, dhe atë konkretisht kur kishin vendosur për transferimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale<sup>39</sup>. Më 6 janar 2017, Kryeprokurori i Shtetit ka “transferuar përkohësisht” prokurorin e Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Sylë Hoxha në PSRK dhe krejt kjo në kundërshtim me rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit. E njëjta kishte ndodhur edhe me prokurorin Abdurrahim Islami, i cili në kundërshtim me ligjin dhe Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve ishte transferuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në PSRK.<sup>40</sup>

---

<sup>37</sup> *Strategjia në udhëkryq*, IKD, qershor 2024, - f.21 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf>), (Qasur herën e fundit me 11 dhejtor 2024)

<sup>38</sup> *Dekada e shkeljeve sistematike të KPK-së*, Betimi për Drejtësi, 21 shtator 2024 (<https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-live-dekada-e-shkeljeve-sistematike-te-kpk-se/>)

<sup>39</sup> Vendimet e kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së për transferimin e prokurorëve në PSRK (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/1.-Analize-e-shkurte-Vendimet-e-kunderligjshme-te-KPSH-dhe-KPK-07.02.2017-2.pdf>), (Qasur herën e fundit me 11 dhejtor 2024)

<sup>40</sup> IKD reagon kundër vendimeve të kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial për transferimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale, 07 shkurt 2017, (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-reagon-kunder-vendimeve-te-kunderligjshme-te-kryeprokurorit-te-shtetit-dhe-keshillit-prokurorial-per-transferimin-e-prokuroreve-ne-prokurorine-speciale/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhejtor 2024)

Kundërligjshmëria e proceseve të KPK-së vijoj me përzgjedhjen e ish-kryesuesit të KPK Blerim Isufaj në pozitën e Kryeprokurorit të PSRK.

Pas përfundimit të mandatit të kryesuesit, Isufaj kishte mandat edhe dy vjet si anëtar i KPK.. Por, z. Isufaj edhe pse kishte marr mandatin nga prokuroret për ti përfaqësuar për pese vite si anëtarë i Këshillit, pas dy muajsh pasi kishte përfunduar mandatin si kryesues i KPK, në mars të 2019, ai kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit, për te garuar për pozitën e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale.

IKD kishte monitoruar me kujdes procesin e emërimit të kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe bazuar në gjetjet e monitorimit, kishte reaguar publikisht duke vlerësuar se ky proces nuk i kishte plotësuar standardet e kërkuara, për të siguruar një proces të drejtë e të pavarur dhe të paanashëm<sup>41</sup>.

Për më tepër, IKD kishte gjetur se zgjedhja e Isufajt në pozitën e Kryeprokurorit të PSRK përbënte konflikt të interesit. Për këtë, IKD kishte alarmuar KPK-në, Agjencinë Kundër Korrupsion dhe publikun se Blerim Isufaj po merrte pozitën e kryeprokurorit të Speciales duke shkelur ligjin. Mirëpo edhe përballë këtyre gjetjeve mungonte vullneti i KPK-së për të shmangur situatat me konflikt të interesit duke zgjedhur Isufajn në krye të PSRK-së. Se IKD kishte pasur të drejtë e vërteton edhe opinioni i AKK-së më 4 mars 2022 ku kishte konstatuar se emërimi eventual i ish-anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit pa kaluar afati prej dy vjetëve nga përfundimi i mandatit në KPK, bie ndesh me ligjin për konflikt të interesit. Ky opinion ishte nxjerr në rastin e Arben Ismajlit, i cili kishte kandiduar për pozitën e të parit të KPSH-së. Situatë identike ishte edhe kur Blerim Isufaj ishte zgjedhur kryeprokuror i Prokurorisë Speciale, menjëherë pasi kishte dhënë dorëheqje nga KPK, por rasti i Isufajt nuk ishte trajtuar asnjëherë nga Agjencia Kundër Korrupsionit<sup>42</sup>.

Në prill të vitit 2022 i përfundonte mandati Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi. Gjatë kohës kur ishte duke u diskutuar ndryshimi i Ligjit për KPK, KPK shpalli konkursin për Kryeprokurorë të Shtetit. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit u monitoruar nga IKD, GLPS dhe Lëvizja Fol. Raporti i monitorimit të këtij procesi theksonte se Paneli Vlerësues kishte vlerësuar kandidatët në mënyrë qartazi të pabazuar, duke cenuar meritokracinë e procesit. Isufaj, i cili u propozua për Kryeprokuror të ri, ishte vlerësuar me 98 nga gjithsej 100 pikë, megjithëse koncept-dokumenti i tij dhe intervista pranë Komisionit kishin mangësi të mëdha në aspektin profesional, që vëreheshin lehtësisht. Si rrjedhojë, Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile rekomandonte që i tërë procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të Kryeprokurorit të ri të Shtetit të anulohet dhe të përsëritej, ashtu që të evitoheshin shkeljet

---

<sup>41</sup> IKD reagon lidhur me integritetin e kontestuar të procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, 23 dhjetor 2019, (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-reagon-lidhur-me-integritetin-e-kontestuar-te-procesit-te-emerimit-te-kryeprokurorit-te-prokurorise-speciale-dhe-kryeprokurorit-te-prokurorise-themelore-ne-prishtine/>), (Qasur herën e fundit me datën 11 dhjetor 2024)

<sup>42</sup> Konflikti i interesit në avancime dhe përfitime në Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial (Shih linkun: [file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Raporti-per-shtesat-ne-KGJK-KPK-1%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Raporti-per-shtesat-ne-KGJK-KPK-1%20(2).pdf)), (Qasur herën e fundit me datën 11 dhjetor 2024)

procedurale dhe defektet e evidentuara<sup>43</sup>. Me gjithë vërejtjet dhe kritikave objektive të bëra, KPK kishte rekomanduar për dekretim z. Isufaj në mënyrë unanime<sup>44</sup>. Mendësia korporatiste bëri që KPK mos të reflektonte përballë kritikave të shoqërisë civile, kritikave të partnerëve ndërkombëtare dhe shkelje të evidentuara nga Presidentja e Republikës së Kosovës, e cila çështje tanimë u elaborua në këtë raport.

Mendësia korporatiste e KPK u ndoq edhe në rastin e ish-kryesuesit Bahri Hyseni, i cili u avancua nga Departamenti më i ulët i Prokurorisë Themelore drejte e në zyrën më të lartë të këtij institucioni, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Prokurorit Bahri Hyseni i kishte përfunduar mandati si kryesues në KPK në fund të dhjetorit të vitit 2020. Si rrjedhojë e kësaj, nga janari 2021, Hyseni ishte kthyer si prokuror i Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Por, nuk kishte shkuar shumë dhe me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, Hyseni është transferuar për të punuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Një vendim i tillë, ishte marrë në shpërfillje të plotë me dispozitat ligjore si dhe nevojat e ZKPSH-së. Për më tepër, ky avancim në emër të transferimit përbënte edhe konflikt të interesit. Vendimin e përkohshëm për transferimit të Hysenit, KPK e shndërroj në të përhershëm, duke e avancuar Hysenit me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit<sup>45</sup>.

Kundërligjshmëria e proceseve të KPK nuk u ndal. Me 22 dhjetor 2023, KPK kishte publikuar një shpallje të brendshme për plotësimin e nëntë (9) pozitave për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Përbërja e komisionit të KPK për avancimin e të njëjtëve nuk ishte e ligjshme. Lidhur me këtë proces, KPK ka caktuar Komisionin me përbërje që nuk përkon me rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, përkatësisht me nenin 19, par. 2., e cila shprehimisht ka kërkuar që përbërja e komisionit të konsistojë në një anëtar (kryesues) i cili do të jetë Kryeprokurori i Shtetit, një anëtar nga radhët e Këshillit Prokurorial dhe një anëtar nga Prokuroria e Apelit. Ndërkaq, përbërja e komisionit ishte qartazi në kundërshtim me rregulloren, pasi që në këtë komision nuk pati asnjë anëtarë nga Prokuroria e Apelit. Megjithatë një anëtar i komisionit, përkatësisht prokurori Arian Gashi është prokuror në Prokurorinë e Apelit, i njëjti ka qenë i emëruar si anëtar nga radhët e KPK-së dhe jo nga Prokuroria e Apelit. Edhe sikur të kishim të bënim me situatën që i njëjti është i emëruar si anëtar i këtij Komisioni nga radhët e Prokurorisë së Apelit, përsëri jemi në situatën që kemi shkelje të rregullores dhe Komisioni përsëri është i kundërligjshëm. Kjo sepse, në rastin e tillë, atëherë do të kishim të pa përfaqësuar në Komision anëtarin nga radhët e KPK-së<sup>46</sup>.

---

<sup>43</sup> IKD reagon lidhur me integritetin e kontestuar të procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, 23 dhjetor 2019, (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-reagon-lidhur-me-integritetin-e-kontestuar-te-procesit-te-emerimit-te-kryeprokurorit-te-prokurorise-speciale-dhe-kryeprokurorit-te-prokurorise-themelore-ne-prishtine/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>44</sup> Reagimi I koalicionit kur është rekomanduar.

<sup>45</sup> IKD: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me shumë prokurorë të avancuar në mënyrë të kundërligjshme dhe me mijëra euro shtesa të palejuara, 13 shkurt 2021, (shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-zyra-e-kryeprokurorit-te-shtetit-me-shume-prokurore-te-avancuar-ne-menyre-te-kunderligjshme-dhe-me-mijera-euro-shtesa-te-palejuara/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>46</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=4HxIqlGUyls> ; Rregullore nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, neni 19 (Shih linkun: [Rregullore-Nr.02.2021-per-Transferimin-dhe-Avancimin-e-Prokurore-ve-te-Shtetit-nr.1664.2021-1.pdf](https://www.youtube.com/watch?v=4HxIqlGUyls))

Ndaj vendimit për transferimin e këtyre prokurorëve, IKD me 20 maj 2024 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Përderisa kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të këtij vendimi është refuzuar, për këtë rast, ende nuk është marrë një vendim meritator<sup>47</sup>.

Gjatë monitorimit të KPK, IKD gjeti se KPK kishte mbajtur peng njërin kandidat për avancim, në kundërshtimin e të cilit nuk ishte vendosur gjatë procesit të avancimit<sup>48</sup>.

KPK nuk zhvilloj procese të kontestuara vetëm për avancimin e prokurorëve. I tillë është edhe procesi i fundit për rekrutimin e prokurorëve, monitorimin e të cilit nuk e lejoj KPK<sup>49</sup>. Bëhet fjalë për konkursin për 28 prokurorë të rinj, i cili u hap nga KPK me 22 janar 2024. Në këtë konkurs kanë aplikuar 422 kandidatë për 28 pozita, apo 15 persona për një pozitë të prokurorit. Për këtë proces, KPK nuk qe e gatshme të ofroj transparencë. Më 5 shtator, IKD, INPO dhe FOL, kanë njoftuar përmes emailit se do ta monitorojnë procesin e intervistave të kandidatëve për prokurorë. Por, as Këshilli Prokurorial e as Komisioni Vlerësues nuk ka kthyer përgjigje. Pas paralajmërimit me email, organizatat e shoqërisë civile shkuan në mëngjesin e datës 9 shtator për ta monitoruar procesin e intervistave të kandidatëve për prokurorë. Monitorimi i intervistave të kandidatëve për prokurorë nuk u lejua<sup>50</sup>.

Këto të dhëna tregojnë haptazi tendencën për kontrollë të vazhdueshëm të funksionimit të sistemit prokurorial, duke funksionuar përmes mendësisë korporatiste, ku krijohet përcëptimi se figurave të ndryshme brenda sistemit prokurorial u bëhen favore të ndryshme, pa marrë parasysh ligjin. Përderisa njëri ish-kryesues avancohet nga niveli më i ulët brenda sistemit prokurorial në nivelin më të lartë të tij dhe tjetri zgjidhet kundërligjshëm në krye të PSRK, tregon për një favorizim të qartë të kryesuesve të KPK pasi ata ta përfundojnë mandatin e tyre. Shtuar këtu avancimet e kundërligjshme dhe proceset jo transparente të rekrutimit të prokurorëve të rinjë, kjo situatë është dëshmi praktikë që ilustron funksionimin korporatist të KPK, përbërjen korporatiste të së cilit e konfirmoj Komisioni i Venecias.

#### f. Riciklimi në sistemin prokurorial

Riciklimi i të njëjtave figura në pozita kyçe të sistemit prokurorial të Kosovës ka krijuar një mjedis ku ndryshimi dhe progresi janë bërë pothuajse të pamundura. Kjo qasje ka kontribuar në ndërtimin e një mendësie korporatiste brenda sistemit, e cila shpeshherë ka penguar

---

<sup>47</sup> Dekada e shkeljeve sistematike të KPK-së, Betimi për Drejtësi, 21 shtator 2024, (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=4HxIqlGUyls>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>48</sup> Pas mbajtjes “peng” nga kryesuesi Hajdaraj për katër muaj, KPK-ja diskuton për kundërshtimin e prokurorit Arben Ismajli për transferim në PSRK, Betimi për Drejtësi, 27 gusht 2024, (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-mbajtjes-peng-nga-kryesuesi-hajdaraj-per-kater-muaj-kpk-ja-diskuton-per-kundershtimin-e-prokurorit-arben-ismajli-per-transferim-ne-psrk/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>49</sup> Organizatat joqeveritare IKD, Lëvizja FOL dhe INPO nuk lejohen të monitorojnë procesin e intervistimit të kandidatëve për prokurorë, IKD, 9 shtator 2024, (shih linkun: <https://kli-ks.org/organizatat-joqeveritare-ikd-levizja-fol-dhe-inpo-nuk-lejohen-te-monitorojne-procesin-e-intervistimit-te-kandidateve-per-prokurore/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>50</sup> Po aty

transparencën, meritokracinë dhe llogaridhënien. Për më shumë se një dekadë, sistemi prokurorial është përballur me sfida të theksuara në krijimin e një sistemi të drejtësisë që i shërben me përkushtim interesit publik. Në vend të promovimit të figurave të reja, proceset përzgjedhëse shpeshherë janë dominuar nga figura të njëjta, të cilat kanë ndikuar në ruajtjen e një status quo-je problematike.

- Jetish Maloku

Më 8 mars 2010, ishte emëruar anëtar në atë kohë i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. Pas pavarësimit të Këshillit Prokurorial, në shkurt 2011, Maloku ishte transferuar si anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës deri në fund të vitit 2015.

Maloku, së bashku me anëtarët e tjerë të Këshillit, kishte vendosur të tejkaloj për tetë muaj mandatin e rregullt. Kjo ishte kontestuar nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Derisa ishte anëtar i Këshillit Prokurorial, Maloku nga e njëjta përbërje e kolegëve të Këshillit ishte emëruar në janar 2013 si Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjilan. Në këtë pozitë ishte riemëruar në vitin 2017, duke e ushtruar atë deri në fund të vitit 2020. Në tetor të këtij viti, Maloku ka dhënë dorëheqje për të kandiduar si anëtar i Këshillit Prokurorial. Përkundër reagimeve publike se i njëjti ligjërishit e ka të ndaluar të zgjidhet në këtë pozitë për shkak se paraprakisht kishte konsumuar një mandatit, Jetishi u rikthye në KPK. Në janar të vitit 2021, Maloku ishte vendosur në krye të Këshillit Prokurorial të Kosovës për të qëndruar deri në vitin 2023 ku me përfundimin e kësaj pozite tash vijon të jetë anëtar i KPK-së.

- Blerim Isufaj

Isufaj ishte emëruar prokuror në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë në korrik 2010, e cila aso kohe udhëhiqej nga Aleksandër Lumezi.

Në gusht 2013, prokurori Isufaj, ngritët në detyrë në Prokurorinë Speciale. Gjatë vitit 2015, në kohën kur Këshilli Prokurorial udhëhiqej nga Aleksandër Lumezi, Blerim Isufaj merr bekimin e prokurorëve në Prokurori Speciale dhe caktohet si anëtar i KPK nga radhët e kësaj Prokurorie. Në fillim të vitit 2016, emërohet Kryesues i KPK, duke trashëguar pozitën e Aleksandër Lumezit, i cili me ligjin e ri, ishte anëtar i KPK.

Në garën për Kryesues, Blerim Isufaj kishte kundërkandidat Bahri Hysenin, i cili ishte zgjedhur si anëtar i KPK nga prokurorët e Ferizajit. Në kohën kur kishte kandiduar për këtë pozitë ishte ende prokuror me mandat fillestar. Isufaj deri në janar të vitit 2019 për tri vite ka drejtuar KPK-në. Pas skadimit të mandatit të Kryesuesit, ai ka pasur mandat edhe dy vite si anëtar i Këshillit, por pasa dy muajve, në mars të vitit 2019, ai ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit. Arsye ishte pozita e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale.

Në janar të vitit 2020, anëtarët e KPK, të cilët dikur i kishte vartës, kanë zgjedhur Isufajn për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale, me 10 vota për dhe asnjë kundër.

Në të njëjtën kohë, ishte zhvilluar edhe procesi i emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ku ishte zgjedhur Kujtim Munishi. Për këto procese, të cilat ishin monitoruar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, ata janë shprehur të zhgënjyer.

*“Ambasada Amerikane nuk e mbështet dështimin e Këshillit Prokurorial për të zbatuar Rregulloren për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Ne iu dëshirojmë Kryeprokurorëve sukses dhe mungesa e mbështetjes sonë për procesin e përzgjedhjes nuk reflekton opinionin tonë individual për personat e zgjedhur. Publiku duhet të ketë besim në KPK në zbatimin e rregullave të saj dhe rregulloreve dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve në bazë të meritës përmes një procesi që promovon transparencën”,* thuhet në përgjigjen e Ambasadës Amerikanë në Prishtinë dhënë për “Betimi për Drejtësi”<sup>51</sup>.

Blerim Isufaj, deri më tash asnjë mandat nuk e ka përfunduar deri në fund. Së fundi, ia ka mësyre edhe garës për Kryeprokuror të Shtetit, për ta zëvendësuar edhe njëherë shefin e tij, Aleksandër Lumezi, duke lënë kështu në gjysmë mandatin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale.

#### 4. Nevoja për reformë

Siç u përmend, Komisioni i Venecias theksoj se “KPK-ja aktuale përbëhet pothuajse tërësisht nga prokurorë dhe, për këtë arsye, është e prirur ndaj rrezikut të korporatizmit. Për më tepër, në Kosovë, shumica e anëtarëve prokurorial të KPK-së vijnë nga zyrat prokuroriale të niveleve të ulëta. Është krejtësisht e natyrshme që, edhe në mungesë të një lidhje formale subordinimi, ata mund të perceptohen se votojnë së bashku me kolegët e tyre të nivelit më të lartë, dhe në veçanti me Kryeprokurorin e Shtetit. Siç kanë dëshmuar disa OJQ, pikërisht kështu ka funksionuar KPK-ja në të kaluarën”<sup>52</sup>. Dëshmia që përmend Komisioni i Venecias u paraqit në çështjet e elaboruara në këtë raport të cilat, natyrisht, nuk janë shteruese. Por, situatat e paraqitura, tregojnë qartazi se puna e KPK nuk është e orientuar drejt përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore që ka KPK, por është e udhëhequr nga një mendësi korporatiste brenda KPK.

Në këtë situatë, efektet negative të korporatizmit të konstatuar nga Komisioni i Venecias, shoqëria kosovare është duke i vuajtur tash e sa kohë. Nevoja për një sistem prokurorial të pavarur, profesional, transparent dhe llogaridhënës është kryesore. Fatkeqësisht, rastet e

---

<sup>51</sup> *Ambasada Amerikane nuk e mbështet dështimin e KPK-së për të zbatuar Rregulloren për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë*, Betimi për Drejtësi, 27 dhjetor 2019, [Ambasada Amerikane nuk e mbështet dështimin e KPK-së për të zbatuar Rregulloren për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Betimi për Drejtësi](#), (Qasur për herën e fundit 11 dhejtor 2024).

<sup>52</sup> *Raporti i Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit*, par.27 (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)051-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)051-e), (Qasur për herën e fundit 11 dhejtor 2024).



paraqitura në këtë raport dëshmojnë se KPK e ka bërë pothuajse të kundërtën, duke ndërtuar një kulturë korporatiste të funksionimit.

Për këto arsye, reforma në KPK nuk ka alternativë. Ajo duhet të ndodhë. Deri më tani, për vite me radhë, është dëshmuar se ndryshimi i anëtarëve të KPK nuk sjellë rezultate. Riciklimi i vazhdueshëm i figurave brenda sistemit prokurorial e ka zbehur këtë mundësi. Për këtë arsye, kërkohet një reformë e cila ndryshon kompozimin e KPK, përkatësisht përbërjen e saj, në mënyrë që objektivisht, të pamundësohet mundësia e veprimit korporatist brenda sistemit prokurorial.

## 5. Çfarë synohet të arrijë reforma në KPK?

Reforma në sistemin prokurorial të Kosovës nënkupton synimin për ndryshimin e përbërjes së KPK. Kjo në atë mënyrë që përbërja e KPK mos të ketë mundësi objektivisht të veprojë në mënyrë korporatiste.

Në linjë me gjetjet e procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, opinioneve të Komisionit të Venecias dhe përpjekjeve të deritanishme, është e domosdoshme që numri i anëtarëve të KPK të ulet dhe, veçanërisht, të balancohet. Balancimi në rastin konkret konsiston në nevojën e uljes së përfaqësimit të anëtarëve prokurorë, të cilët zgjidhen nga kolegët e tyre, në KPK.

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka KPK, si një institucion kyç i sistemit të drejtësisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, reforma nuk duhet të synoj ndikimin politik të KPK. Kjo reformë duhet të krijoj një balancë adekuate në KPK, duke shndërruar mendësinë korporatiste me mendësinë e llogaridhënies, transparencës dhe meritokracisë.

Në kuptim të këtij balanci, anëtarët prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre nuk duhet të jenë një shumicë lehtë e nënshtruar nga anëtarët e tjerë. Megjithatë, të njëjtit nuk duhet ta kenë dominancën absolute brenda KPK duke i bërë jo relevant pjesën tjetër të anëtarëve. Duke e adresuar në mënyrë të drejtë këtë situatë si dhe duke respektuar të drejtat individuale kushtetuese në secilin rast, reforma në KPK duhet ta largojë mundësinë e veprimit korporatist brenda këtij sistemi, duke e larguar kulturën e pandëshkueshmërisë, kulturë kjo tanimë e mirë etabluar brenda sistemit prokurorial të Kosovës.

## 6. Dështimet në reformë

Përgjatë gjithë mandatit të saj qeverisë, Qeveria Kurti II është duke tentuar të realizoj reformën në sistemin prokurorial të Kosovës. Aktualisht, për të dytën herë, reforma është duke iu nënshtruar testit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese.

Më 26 tetor 2021, Ministria e Drejtësisë, pasi kishte hartuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, iu drejtua Komisionit të Venecias, për të marrë opinion përkatës, nëse

projektligji në fjalë ishte hartuar konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare<sup>53</sup>. Me 13 dhjetor 2021, Komisioni i Venecias publikoi opinionin e saj përkitazi me Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK<sup>54</sup>.

Pas Opinionit të parë të Komisionit të Venecias, në shkurt 2022, Qeveria hartoi dhe miratoi draftin e dytë të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik. Më 25 shkurt 2022, Qeveria kërkoi një Opinion të dytë nga Komisioni i Venecias, për tu siguruar nëse drafti final i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, kishte adresuar vërejtjet dhe rekomandimet e Opinionit të parë. Më 9 mars 2022, Qeveria, miratoi projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPK<sup>55</sup>. Me 23 mars 2022, Komisioni i Venecias publikoi opinionin e dytë përkitazi me këtë Projektligj<sup>56</sup>. Më 23 qershor 2022, Kuvendi miratoi Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK. Sipas këtij Ligji, KPK do të përbëhej nga shtatë (7) anëtarë: katër (4) prokurorë dhe tre (3) jo prokurorë<sup>57</sup>.

Më 1 korrik 2022, PDK dhe LDK e dërguan Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. Nëntë (9) muaj pas, me 5 prill 2023, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se Ligji në fjalë nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke e shfuqizuar në tërësi këtë ligj<sup>58</sup>.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila rrëzoi tërësisht Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu mbajti konferencë për media sipas së cilës GjK po e sheh më të rëndësishëm interesin individual të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës së sa interesin e përgjithshëm<sup>59</sup>. Kjo deklaratë përbënte ndërhyrje në punën e Gjykatës Kushtetuese<sup>60</sup>.

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Qeveria u fut në eksperimente, përmes të cilave rrezikohej pavarësia e KPK. Më 12 korrik 2024, Qeveria e Kosovës miratoi një version të ri të Projektligjit për KPK, i cili shtoi numrin e anëtarëve në 19 deri më 2026, përkundër qëllimit fillestar për reduktimin e tyre. Ndryshimet e reja përfshijnë përfshirjen e anëtarëve të zgjedhur

---

<sup>53</sup>Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 5 prill 2023, (Shih linkun: [https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>54</sup> *Raporti i Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit*, par.32-34(Shih linkun: [https://venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)051-e](https://venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)051-e)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>55</sup>Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 5 prill 2023, [https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>56</sup> *Raporti i Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit*, (Shih linkun: [https://venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)006-e](https://venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)006-e)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>57</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, f.34 [https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>58</sup> Po aty, dispozitivi

<sup>59</sup> *Ministrja e Drejtësisë: Për Gjykatën Kushtetuese më i rëndësishëm interesi i disa anëtarëve të KPK-së se sa interesi i përgjithshëm*, Betimi për Drejtësi, 25 mars 2023,(Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-e-drejtësisë-per-gjykatën-kushtetuese-me-i-rendesishem-interesi-i-disa-anetareve-te-kpk-se-se-sa-interesi-i-pergjithshem/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>60</sup>IKD, Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike, (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Nderhyrjet-ne-sistemin-e-drejtësisë-permes-deklaratave-publike-1-1.pdf>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

nga Kuvendi, të cilat përbënin politizim të institucionit dhe shkelje të Kushtetutës, Strategjisë për Sundim të Ligjit dhe opinioneve të Komisionit të Venecias. IKD dhe Lëvizja FOL kritikuan projektligjin për cenimin e pavarësisë së KPK-së dhe për rrezikun e bllokadës vendimmarrëse, duke theksuar se këto zgjidhje nuk reflektojnë një reformë të mirëfilltë dhe kanë neglizhuar rekomandimet për një strukturë më të balancuar dhe të pavarur<sup>61</sup>.

Komisioni i Venecias, në opinionin e publikuar me 18 dhjetor 2023 për Projektligjin e ri për KPK<sup>62</sup>, nuk i ka mbështetur ndryshimet e reja sa i përket rritjes së përkohshme të numrit të anëtarëve në KPK në 19 anëtarë deri në janar të vitit 2026, ndryshime këto të propozuara me versionin e ri të Projektligjit për KPK, pas ndryshimeve të bëra nga Ministria e Drejtësisë<sup>63</sup>. Pas këtij opinioni, Qeveria dhe Kuvendi ndryshuan qasje, duke zgjedhur një model të uljes graduale të numrit të anëtarëve prokurorë në KPK. Ligji i ri për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK u miratua nga Kuvendi më 11 korrik 2024<sup>64</sup>.

Përkundër tërheqjes, eksperimentimi i Qeverisë me reformën për KPK pati koston e saj. Nëse Qeveria ndërhyri në punën e Gjykatës Kushtetuese me arsyetimin se iu deshën nëntë (9) muaj për të nxjerrë aktgjykimin përkritazi me Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK, Qeverisë dhe Kuvendit iu deshën mbi 15 muaj për të adresuar gjetjet e Gjykatës Kushtetuese.

Edhe Ligji i ri për KPK, që synon uljen graduale të numrit të anëtarëve të KPK, u dërgua nga opozita për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese<sup>65</sup>. Aktualisht, Gjykata Kushtetuese është duke e shqyrtuar kushtetutshmërinë e këtij Projektligji, i cili do të mbetet pezull deri në vendosjen e Gjykatës Kushtetuese.

Në Raportin e Vendit për Kosovën, Komisioni Evropian theksoj se “Pavarësisht këshillave të forta nga BE-ja, Komisioni i Venecias nuk u konsultua nga qeveria dhe Kuvendi për ndryshimet përfundimtare në ligjin për KPK-në”<sup>66</sup>. Kështu, kritika e vetme e Bashkimit Evropian përkritazi me Projektligjin e ri për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK ishte mos ridërgimi i këtij

---

<sup>61</sup>IKD dhe FOL: *Projektligji i ri, politizim objektiv i Këshillit Prokurorial të Kosovës*, 17 korrik 2023, (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-projektligji-i-ri-politizim-objektiv-i-keshillit-prokurorial-te-kosoves/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>62</sup> *Raporti i Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit*, (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2023\)043-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2023)043-e)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>63</sup>IKD dhe FOL: *Komisioni i Venecias s'i përkrahu ndryshimet e MD-së për rritjen e përkohshme të anëtarëve të KPK-së në 19 deri në janar të vitit 2026*, IKD, 20 dhjetor 2023, (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-komisioni-i-venecias-si-perkrah-ndryshimet-e-md-se-per-rritjen-e-perkohshme-te-anetareve-te-kpk-se-ne-19-deri-ne-janar-te-vitit-2026/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>64</sup>Kuvendi miraton projektligjin për KPK-në, përkundër kritikave nga BE-ja, Dukagjini, 11 korrik 2024, (Shih linkun: <https://www.dukagjini.com/kuvendi-miraton-projektligjin-per-kpk-ne-perkunder-kritikave-nga-be-ja/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024)

<sup>65</sup> *PDK dërgon në Kushtetuese ligjet për KPM-në, KPK-në dhe statutin për UP-në*, Radio Evropa e lirë, 18 korrik 2024, (shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/pdk-kushtetuese-ligje-kpm-kpk-/33041705.html>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024), *LDK-ja i dërgon në Kushtetuese ligjet për KPM-në, KPK-në dhe statutin e UP-së*, Albanian Post, 19 korrik 2024, (Shih linkun: <https://albanianpost.com/ldk-ja-i-dergon-ne-kushtetuese-ligjet-per-kpm-ne-kpk-ne-dhe-statutin-e-up-se/>), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

<sup>66</sup> Dokumenti i punës së stafi i Komisionit Evropian për Kosovës 2024, fq.5 (Shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)), (Qasur herën e fundit me 11 dhjetor 2024).

Projektligji për vlerësim nga Gjykata Kushtetuese. Kështu, përballë mos shprehjes së dilemave konkrete, duket se një vlerësim i tillë i Raportit të Komisionit Evropian për Vënie si rezultat i një mos besimi ndaj qeverisë në procesin e ligjëbërjes.

Përtej të gjithave, duke respektuar pavarësinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, opinionet e Komisionit të Venecias dhe gjetjet e procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, me qëllim të ndalimit të korporatizimit brenda sistemit prokurorial të Kosovës, reforma në KPK duhet të ndodhë dhe ajo nuk ka alternativë.